



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2020:104960
Datë: 13.05.2024
Numri i dokumentit: 05677724

C.nr.1364/20

Gjykata Themelore në Ferizaj, Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari Armend Ahmeti, në çështjen juridike kontestimore të paditësit Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike sh.a me seli në Prishtinë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson T.K., kundër të paditurit N.T., me vendbanim në rrugën “...”, nr...., Prishtinë, me numër personal ..., me objekt kontesti kompensim i dëmit material, me vlerë të kontestit 2,433.77€, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor dhe publik të datës 29.04.2024 në prezencë të përfaqësueses së paditësit mori, kurse më datën 13.05.2024, përpiloi me shkrim këtë:

A K T G J Y K I M

- I. Refuzohet si e pabazuar kërkesëpadia e paditësit Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike sh.a me seli në Prishtinë, kundër të paditurit N.T. nga Prishtina, me të cilën ka kërkuar që të obligohet i padituri që paditësit të i paguaj dëmin e shkaktuar material në shumë prej 2,433.77€ dhe atë me kamatë ligjore duke filluar prej ditës së ushtrimit të padisë e gjerë në pagesën definitive si dhe shpenzimet e këtij kontesti – të gjitha në afat prej 15 ditësh me kërcënimin e përmbarimit.
- II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta të procedurës kontestimore.

A r s y e t i m

Pretendimet e palëve ndërgjyqëse

Paditësi me datë 28.08.2020 ka paraqitur padi në këtë gjykatë me kërkesë për kompensimin e dëmit material, përgjatë seancës kryesore dhe në fjalë përfundimtare e autorizuara e paditësit ka kërkuar nga gjykata që të aprovohet kërkesëpadia ashtu që obligohet i padituri që paditësit të i

paguaj dëmin e shkaktuar material në shumë prej 2,433.77€ dhe atë me kamatë ligjore duke filluar prej ditës së ushtrimit të padisë e gjerë në pagesën definitive si dhe shpenzimet e këtij kontesti – të gjitha në afat prej 15 ditësh me kërcënimin e përmbarimit. Kërkesëpadinë e ka bazuar në Procesverbalin e kontrollës së konsumatorit me nr. ... i dt. 11.04.2014, faturën për shkaktimin e dëmit Nr.... e dt. 29.04.2014, procesverbalin e datës 28.03.2014 me numër 23/28, fotodokumentacionin dhe kallëzimin penal i dt. 08.05.2014 i dorëzuar në Prokurorinë Themelore në Ferizaj. Gjykatës i ka propozuar që të aprovohet në tërësi padia dhe kërkesëpadia e paditësit si e bazuar.

I padituri në përgjigje në padi e ka kontestuar në tërësi kërkesëpadinë e paditësit duke vlerësuar se nuk ka bazë ligjore pasi që pretendimet e paditësit janë të pambështetura sepse i padituri që prej datës 30.09.2013 nuk e ka shfrytëzuar lokalin ku është furnizuar me energji elektrike, e cila vërtetohet nga “Shkëputja e kontratës me qera të lokalit afarist” e datës 30.09.2013, si dhe kërkesa për kompensim dëmi e njëjta është parashkruar. Gjykatës i ka propozuar që të refuzohet në tërësi e pabazuar padia dhe kërkesëpadia e paditësit.

Provat e administruara në shqyrtimin kryesor

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, lidhur me çështjen konkrete juridike, në shqyrtimin kryesor, gjykata bëri administrimin e provave si: Procesverbali i datës 12.04.2014 me numër ..., fatura e datës 29.04.2014, me numër ..., procesverbali i datës 28.03.2014 me numër 23/28, gjashtë foto në fletë A4, kallëzimi penal numër ... i datës 08.05.2014, aktvendimi i Gjykatës Themelore në Ferizaj P.nr.03/15 i datës 28.04.2020, si dhe Shkresa “Shkëputje e kontratës me qira lokali afarist” e datës 30.09.2013.

Gjykata pas vlerësimit të pohimeve të palëve ndërgjyqëse dhe provave të nxjerra në kuptim të nenit 8 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK), me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha ato së bashku, ka gjetur se kërkesëpadia e paditësit është e pabazuar.

Gjendja faktike e vërtetuar dhe vlerësimi përfundimtar i gjykatës

Nuk ishte kontestues fakti se i padituri N.T., ishte konsumator i kompanisë KEDS. Gjithashtu nuk ishte kontestues as fakti se ndaj të paditurit është pushuar procedura penale dhe është hedhur

poshtë aktakuza e Prokurorisë Themelore në Ferizaj me aktvendimin P.nr.03/15, të datës 28.04.2020, të Gjykatës Themelore në Ferizaj.

Kontestuese në këtë rast ka qenë baza juridike e kërkesëpadisë, lartësia e kërkesës, por edhe parashkrimi i kësaj kërkesës, meqë është thirrur pala e paditur.

Meqenëse baza juridike e kërkesëpadisë dhe lartësia e saj kanë qenë kontestuese në këtë çështje juridike, ndërsa asnjëra nga palët nuk kanë propozuar nxjerrjen e provës me ekspertizë nga lëmi i elektros, me të cilën do të vërtetohej baza juridike por edhe lartësia e kërkesës, gjykata në seancën përgatitore të mbajtur më datën 20.03.2024 sipas detyrës zyrtare me aktvendim ka caktuar nxjerrjen e provës me ekspertizë nga lëmi i elektros. Prandaj, meqë gjykata ka caktuar nxjerrjen e provës me ekspertizë sipas detyrës zyrtare, në këtë rast e ka detyruar paditësen që në afatin prej 15 ditëve nga dita e pranimit të këtij aktvendimi, në llogarinë e arkës së kësaj gjykate të deponojë shumën prej 150.00 euro në emër të ekspertizës nga lëmi i elektros, ku është paralajmëruar se në rast se nuk e deponon shumën prej 150.00 euro, do të konsiderohet se ka hequr dorë nga nxjerrja e provës me ekspertizë nga lëmi i elektros. Meqenëse ka kaluar afati prej 15 ditëve nga dita kur gjykata e ka detyruar paditësen që ta deponojë shumën prej 150.00 euro në emër të ekspertizës nga lëmi i elektros dhe paditësja nuk ka vepruar sipas aktvendimit të datës 20.03.2024, është konsideruar se paditësja ka hequr dorë nga nxjerrja e kësaj prove. Sa i përket nxjerrjes së provës me ekspertizë sipas detyrës zyrtare, gjykata një vendim të tillë e ka marrë duke u bazuar në nenin 356 të LPK-së, i plotësuar me nenin 21 të Ligjit Nr. 04/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit bazik, sipas të cilit “Gjykata ex officio ose me propozimin e palëve mundë të bëjë të provuarit me anë të ekspertizës, sa herë që për vërtetimin apo sqarimin e fakteve, apo të rrethanave të caktuara nevojitet dijëni profesionale të cilën nuk e ka gjyqtari i çështjes”. Prandaj, meqenëse çështjet e ngritura nuk hyjnë në vërtetimin e fakteve nga neni 3.3 i LPK-së, barra e provave për vërtetimin e fakteve që janë me rëndësi për nxjerrjen e të drejtës subjektive i bien paditësit. Prandaj, meqenëse paditësja ka hequr dorë nga nxjerrja e provës me ekspertizë nga lëmi i elektros i cili ka qenë i nevojshëm dhe medoemos ta përpiloj dhe mbrojë ekspertizën e tij në këtë lëmi, për shkak se çështjet e paraqitura në këtë padi i tejkalojnë njohurinë që gjykata mund të ketë në këtë çështje, dhe nuk është vërtetuar as baza juridike e as lartësia e kërkesëpadisë, gjykata ka vendosur që ta refuzoj në tërësi si të pabazuar kërkesëpadinë e paditëses. Deri te ky vlerësim kjo gjykatë ka ardhur për faktin se barra e të provuarit të ekzistimit të ndonjë të drejte subjektive e cila buron nga e drejta objektive i takon parashtruesit të kërkesës, në këtë rast paditësit. Deri te ky vlerësim kjo gjykatë ka ardhur duke u bazuar në nenin 7.1 të

LPK-së sipas të cilit “Palët kanë për detyrë të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla”. Ndërsa në nenin 7.3 të LPK-së parashihet që “Gjykata nuk mund ta bazojë vendimin e vet në faktet dhe provat lidhur me të cilat palëve nuk u është dhënë mundësia që të deklarohen”. Në rastin konkret, gjykata i ka cekur se cilat prova i ka administruar, mirëpo për ta vërtetuar bazën juridike të kërkesëpadsisë, përveç provave të administruara ka qenë e nevojshme që të nxjerrët edhe prova me ekspertizë nga lëmi i elektros. Se barra e të provuarit i takon paditësit, parashihet edhe në nenin 322.1 të LPK-së, sipas të cilit “Në qoftë se gjykata në bazë të provave të marra (neni 8 i këtij ligji) nuk mund të konstatojë me siguri ndonjë fakt, për ekzistimin e faktit do të përfundojë duke i aplikuar rregullat mbi barrën e provës”. Ndërsa në nenin 322.2 të LPK-së parashihet që “Pala që pretendon se i takon një e drejtë ka për detyrë të provojë faktin që është qenësor për krijimin ose realizimin e saj, po që se ligji nuk parasheh diç tjetër”. Gjatë gjithë procedurës, gjykata i ka dhënë mundësi që palët ti paraqesin pretendimet dhe provat e tyre dhe meqë nuk ka mundur të provohet as baza juridike e kërkesëpadsisë e as lartësia, me provat që gjykata i kishte në disponim, e ka refuzuar në tërësi si të pabazuar kërkesëpadsinë.

Gjykata ka vendosur që ta refuzojë në tërësi kërkesëpadsinë e palës paditëses, edhe për faktin se nga padia e dorëzuar në këtë gjykatë por edhe nga aktvendimi penal P.nr.03/15, të datës 28.04.2020, i Gjykatës Themelore në Ferizaj, Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal, vërtetohet fakti se dëmi që pretendohet se është shkaktuar ndaj paditëses ka ndodhur më datën e pavërtetuar e deri me datë 28.03.2024, ndërsa padia ndaj të paditurit në këtë gjykatë është dorëzuar më datën 28.08.2020. Nga data e shkaktimit të dëmit e deri në datën e dorëzimit të padsisë kanë kaluar gjashtë vite, pesë muaj e një ditë dhe sipas vlerësimit të kësaj gjykate kemi të bëjmë me parashkrimin e kërkesës. Në këtë drejtim, në bazë të nenit 357 par. 1 të LMD-së parashihet se: “Kërkesa për shpërblimin e dëmit të shkaktuar parashkruhet për tri (3) vite nga data kur i dëmtuari ka marrë dijeni për dëmin dhe për personin, i cili e ka shkaktuar dëmin.”. Ndërsa neni 357 par. 2 i LMD-së parasheh që “Në çdo rast kjo kërkesë parashkruhet për pesë (5) vite nga shkaktimi i dëmit.” Paragrafi 1 i nenit 357 e rregullon çështjen e afatit subjektiv që nënkupton kohën nga e cila është njoftuar vetë paditësja për dëmin dhe personin. Ndërsa, neni 357 par. 2 e rregullon afatin objektiv të parashkrimit që nënkupton se pavarësisht kohës kur i dëmtuari mëson për personin dhe dëmin, me kalimin e afatit 5 vjeçar në çdo rast parashkruhet kjo e drejtë. Andaj në këtë rast ka kaluar si afati subjektiv ashtu edhe afati objektiv. Me nenin 245.1 të LMD parashihet se “1. Kreditori në marrëdhënien e detyrimit ka të drejtë që prej debitorit të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbushë atë me

ndërgjegje dhe në tërësi, në përputhje me përmbajtjen e tij.” Gjithashtu me nenin 358.1 të LMD përcaktohet se “1. Kur dëmi është shkaktuar me veprë penale dhe për ndjekjen penale është parashikuar një afat më i gjatë parashkrimi, kërkesa për shpërblim të dëmit ndaj personit përgjegjës parashkruhet kur të skadojë koha e caktuar për parashkrimin e ndjekjes penale.” Mbi bazën e kësaj gjendje faktike të vërtetuar dhe në kuptim të dispozitave ligjore të lartcekura rezulton i drejtë përfundimi se duhet refuzuar si të pabazuar kërkesëpadinë e paditëses për borxhin e kërkuar për periudhën deri me datën 28.03.2014, në shumën prej 2433,77 euro, për shkak të parashkrimit të kërkesës, pasi që është provuar se paditësja padinë e saj pranë gjykatës së shkallës së parë e ka parashtruar me datën 28.08.2020, në ndërkohë që energjia e shpenzuar elektrike i takon periudhës para muajit mars të vitit 2014. Në rastin konkret kërkesëpadia e paditëses është parashkruar ngase dëmi është shkaktuar me datë 28.03.2014, ndërsa padia për kompensim dëmi në gjykatë është dorëzuar me datë 28.08.2020. Gjithashtu sipas aktvendimit penal P.nr.03/15, të datës 28.04.2020, është hedhur edhe aktakuza dhe është pushuar procedura penale ndaj këtu të paditurit për shkak të parashkrimit absolut të ndjekjes penale, që ka qenë afati 6 vjeçar, e që në rastin konkret është parashkruar. Sipas Nenit 341 të LMD (Rregullat e përgjithshme) parashihet se: “1. Me parashkrim shuhet e drejta e kërimit të përmbushjes së detyrimit. 2. Parashkrimi krijohet kur të ketë kaluar afati i caktuar me ligj, brenda të cilit kreditori ka mundur të kërkojë përmbushjen e detyrimit. 3. Gjykata nuk mund të merr parasysh parashkrimin, në qoftë se debitori nuk thirret në atë.” Sipas Nenit 342 të LMD (Kur fillon të rrjedhë parashkrimi) parashihet se: “1. Parashkrimi fillon të rrjedhë ditën e parë pas ditës kur kreditori të ketë pasur të drejtë të kërkojë përmbushjen e detyrimit, në qoftë se me ligj për raste të veçanta nuk është parashikuar diçka tjetër. 2. Në qoftë se detyrimi konsiston në atë që diçka të mos bëhet, të lihet pa u bërë ose të pësohet, parashkrimi fillon të rrjedhë ditën e parë pas ditës kur debitori të ketë vepruar në kundërshtim me detyrimin.” Sipas Nenit 343 të LMD (Krijimi i parashkrimit) parashihet se: “Parashkrimi lind, kur të ketë skaduar dita e fundit e kohës së caktuar me ligj.”

Gjykata gjatë vendosjes i ka pasur parasysh edhe pretendimet tjera të palëve rreth provave të caktuara, por të njëjtat nuk patën ndonjë ndikim në vendosjen ndryshe të këtij kontesti.

Vendimin mbi shpenzimet procedurale gjykata e mori në kuptim të nenit 450 të LPK-së, në të cilin parashihet se: “Secila palë paraprakisht vetë i bartë harxhimet që i ka shkaktuar me veprimet procedurale të veta.”

Nga të lartcekurat, duke u mbështetur në dispozitat e nenit 357 par. 1 dhe par. 2 të LMD-së, nenit 7.1, 7.3, 8, 143, 322.1, 322.2, 356, 450 dhe 451.3 të LPK-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata Themelore në Ferizaj
C.nr.1364/20, datë 13.05.2024

Gjyqtari
Armend Ahmeti

Këshillë juridike: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.